



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 060/01-16842/24
Kaçanik, 26.07.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VII (shtatë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 26.07 2024, në ora 11:00. Për shkak të kushteve teknike, mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF 7 anëtarëve, anëtari Rustem Zenuni i emëruar në KPF me 28.06.2024, nuk është ftuar në këtë mbledhje, për shkak se vendimit ende nuk është konfirmuar ligjshmëria nga MAPL.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 6 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi. Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Drejtorët e Drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Qamil Stagova-DUKMM, ndërkaq nga zyrtarët: Makfire Malsiu, Mavije Murseli.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoruan: Faruk Dërmaku dhe Arben Shehu.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu- ZLP për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, anëtari i emëruar Rustem Zenuni, nuk është ftuar në këtë mbledhje, për shkak se nuk e kemi ende konfirmimin e ligjshmërisë. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e VII (shtatë) të rregullt të KPF-a për vitin 2024, data 26 korrik, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën: Janar-Qershor 2024;
3. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2023;
4. Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2023;
5. Propozim Vendim për shpallje në interes publik të parcelave kadastrale në Zona kadastrale Kaçanik dhe Kovaçec.

Pika e 5 ka ardhur pak me vonesë, ndërsa për KK është dërguar me kohë. Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 5 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VI (gjashtë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2024 të datës 24.06.2024 / Lënda: 01Nr. 60/01-14085/24

2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën: Janar-Qershor 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Raporti i kryetarit a është sa për njoftim. Ky raport është gati i ngjashëm me raportin financiar.

Kryetari i Komunës: Raporti i kryetarit është vetëm për KK, është hera e parë që hartojmë raport 6 mujor, na kanë detyruar për shkak të grantit të performances. se me ligj raporti bëhet vetëm njëherë në vit.

z. Agim Mani: Të HVK në krahasim me vitin e kaluar, janë në shumë me të vogël, ndërkaq realizimi është më i madh. Kërkoj sqarim se, a janë kategorizuar mirë shpenzimet të mallrat dhe shërbimet të paraqitura në tabelë dhe në formë të shkruar. Të shërbimet e konsulencës dhe kontraktore individuale, A ka pas të drejtë me u paguar këto shërbime nga mallrat dhe shërbimet? E dyta, të mirëmbajtja e rrugëve, a ka pasur të drejtë me u bërë edhe mirëmbajtja e ndriçimit publik me kontratën e lidhur dhe nga ka ardhur shuma 25,039,82€ e inflacionit.

z. Bahri Selimi: Të HVK në këtë 6 mujor kanë shënuar rënie si rezultat i rënies se tatimit në pronë, pasi qeveria e ka fuqizuar një Udhëzim administrativ, sipas të cilës nuk mundemi më me kushtëzuar qytetarin për obligime të papaguara, nuk kemi të drejtë me ua kërkuar borgjin as për regjistrim të automjeteve. E dyta, Ligji për tatimin në pronë ka paraparë lirim të taksapaguesve, se ka shumë prona tatimore që nuk tathohen fare, se e kanë çmimin shumica 15-30 mijë euro. Kemi rënie të HVK të drejtoria e Urbanizmit të lejet ndërtimore, se nuk kemi çdo herë ndërtime, janë me pak 85,400€. Vjet ka pasur ndërtime me tepër, sivjet janë mbledhë vetëm 20,000€. Të mallrat dhe shërbimet, krejt këto që i përmendi Agimi, i takojnë mallrave dhe shërbimeve, se në bazë të planit kontabël të miratuar në thesar, mirëmbajtja e rrugëve lokale, mirëmbajtja e ndriçimit publik, sinjalistika paguhen nga mallrat dhe shërbimet. Nga mallrat dhe shërbimet paguhen edhe shërbimet konsulencës, ndërkaq investimet kapitale, paguhen nga kapitalet.

z. Agim Mani: Të shërbimet konsulentë, i keni paguar mjeket me mjete nga mallrat dhe shërbimet?

z. Bahri Selimi: Janë mjeket specialistë që kryejnë shërbime shëndetësore dhe nuk janë në listë të pagave. Janë diku 5 mjek specialistë që i paguajmë për shërbime konsulentë.

znj. Ardita Rrahmani: Në raport është dhënë arsyetimi i drejtorisë për shumën e vogël të mjeteve nga të HVK. Shqetësim është mungesa e lejeve ndërtimore, si pasojë e kësaj vijnë një varg i problemeve që lidhen me jetën e qytetarëve. Në mbledhje të KK besoj se ka me pasur hapësirë me u diskutuar për rezultatet e ulëta të regjistrimit civil.

znj. Kadrije Lika-Troni: Sa i përket të HVK, po ndalem të taksat tjera administrative. Kemi taksa tjera administrative të DUKMM, njëjtë është edhe të DSHPE dhe DBPZHR. Këto taksa a mund të definohen çfarë janë apo vetëm planifikohen nga viti në vit si total.

z. Bahri Selimi: Ne mundemi me i paraparë shumat të taksat administrative, p.sh. 100,000€, që pastaj shërbimet me i specifikuara. Është shqetësim edhe i yni, se mungon specifikimi i tyre, disa janë certifikata të pronësisë, leje mjedisore dhe si total hynë në taksat tjera administrative. Këto mjete munden me u shpenzuar aty ku janë mbledhur, se ekzistojnë kodet relief, këto mjete nuk janë shtuar.

z. Qamil Stagova: Se çfarë taksash mbledhë komuna, janë të specifikuara në Rregulloren për taksat komunale.

Kryesuesi i Kuvendit: Në raport financiar janë të përmbledhura të HVK si taksa tjera administrative, ndërkaq nuk dihet nga cili pozicion kanë ardhur.

z. Bahri Selimi: Informacioni nuk është bash i plotë, se taksat janë përmbledhur me një emërtim si taksa tjera administrative, nga të gjitha drejtoritë.

z. Agim Mani: Shpenzimet për investime kapitale janë vetëm 13% të realizuara. Pagat dhe mëditjet, pse nuk janë realizuar në shumë 50%?

z. Bahri Selimi: Po, shpenzimet kapitale janë 13% të realizuara. Pagat dhe mëditjet janë 49%, kemi diku ku nuk janë plotësuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, Raportin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF, **Diskutoj Raporti Gjashtëmuor financiar për periudhën: Janar-Qershor 2024 dhe i njëjti i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.**

3. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Raportin e auditorit e keni marrë, besoj se është një ndër raportet me të mira deri tani. Nëse ka kush diçka, urdhëroni.

znj. Ardita Rrahmani: Auditori çdo herë mundet me gjetur gjetje të reja, por ajo që kisha me kërkuar është që, rekomandimet që epën nga raporti i auditorit, në vitin vijues mos të përsëriten. Janë 6 të gjetura që janë barturat nga viti i kaluar. Për gjetjet e reja, ne kemi qenë pjesë e KK dhe e kemi dhënë kontributin tonë, i kemi pasur vërejtjet tona. Për me gjerë lidhur me raportin e auditorit, do të diskutojmë në KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që Raporti i auditorit i ZKA t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi **se KPF diskutoj Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2023. Ky Raport i Auditimit i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë shqyrtimi.**

4. Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Planin e veprimit e keni marrë, i cili hartohet në bazë të raportit të auditimit. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Plani i veprimit a është i vitit 2023?

z. Bahri Selimi: Po, Plani i veprimit është i vitit 2023. Ne i kemi pranuar gjetjet e auditorit dhe po mundohemi me i zbatuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që ky Plan i veprimit t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se, **KPF Diskutoj Planin e Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2023; . Ky plan veprimi i kalohet KK në procedurë shqyrtimi.**

5. Propozim Vendim për shpallje në interes publik të parcelave kadastrale në Zona kadastrale Kaçanik dhe Kovaçec;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Ku gjendet kjo rrugë, cili është interesi i komunës, a keni të drejtë këto parcela në ZK të ndryshme me i vendosur si pako?

z. Qamil Stagova: Prona në ZK Kaçanik, gjendet në rrugën " Ismail Qemali", ndërkaq tjetra është në ZK në Kovaçec.

znj. Ardita Rrahmani: Në Kaçanik, a është prona të Faruk Raka?

z. Qamil Stagova: Po, në atë pjesë është.

znj. Kadrije Lika-Troni: Njëra kërkesë është e vitit 2021, ndërkaq tjetra është e vitit 2024, e datës 08.07.2024. Pse u bërë kjo kërkesë kaq shpejt, a keni kërkesa tjera që janë në pritje me i shpallë pronat interes publik? Pse këto kërkesa po i vendosni në pako?

z. Qamil Stagova: Kërkesa e vitit 2021 na ka humbur, kështu është përsëritur kërkesa. Ka edhe kërkesa tjera, por nuk i plotësojnë kushtet me iniciuar procedurën.

znj. Kadrije Lika-Troni: Një kërkesë e kemi bërë për Kovaçec, për me lëshuar pronë për rrugë. Ajo kërkesë nuk është këtu, d.m.th. qytetarët po lëshojnë pronë për rrugë, ndërkaq kërkesa e tyre nuk është këtu. Komuna ende nuk ka dalë në vendngjarje për këtë kërkesë. Kërkesa që është këtu për f. Kovaçec, është nga familja që ka të punësuar zyrtar këtu dhe në këtë kuptim ka hyrë në proces kjo kërkesë brenda muajit, ndërkaq kjo paraqet konflikt interesi.

z. Qamil Stagova: Nëse kërkesa është me i dhënë tokë komunës, nuk ka nevojë me ardhur fare në KK.

znj. Ardita Rrahmani: Është mirë kur kërkesat trajtohen menjëherë, por është për kritikë nuk gjendet në sirtarë dhe detyrohet pala me përsëritë kërkesën e vet. Nëse kërkesat shqyrtohen brenda muajit, kjo është për me u duartrokitur.

z. Qamil Stagova: Për kërkesat që i adresohen drejtorisë për shpallje interesi për këmbim pronave, fillimisht bëhet shqyrtimi i tyre, vlerësimi i këmbimit në nivel qendror, pastaj bëhet këmbimi.

znj. Kadrije Lika-Troni: Nuk kam asgjë personale ndaj askujt për kërkesën e f. Kovaçec, se janë bashkëfshatarë të mi, por po me duket si konflikt interesi, se ka persona nga ajo familje që punojnë këtu, ndërkaq nuk është e drejtë që brenda muajit me hyrë në proces. Nëse ka kërkesa tjera, është mirë me u bërë publike.

z. Qamil Stagova: Ka kërkesa tjera, mundem me iu njoftuar, por për të njëjtat nuk mendojmë se i plotësojnë kushtet për procedura të mëtejme.

Kryetari i Komunës: Për dy kërkesat që i kemi, të dy familjet kanë të punësuar këtu në komunë. Njëra kërkesë është e Misim Sopa.

z. Agim Mani: Kërkesa e Kadrijes iu ka adresuar organeve të komunës, por e njëjta nuk është shqyrtuar ende.

znj. Kadrije Lika-Troni: Sa është afati me u trajtuar një kërkesë, që komisioni me dalë në vendngjarje, se mua po me pyesin për një kërkesë që e kemi bërë për rrugë? A i kthehet përgjigje palës?

Kryetari i Komunës: Nuk po themi që nuk e keni mirë Kadrije, mos të hymë në këto çështje, se kërkesa ka edhe në ministri që 10 vjet. Me pasur mundësi i kryejmë për 1 muaj.

znj. Kadrije Lika-Troni: Mos mi përziej çështjet me nivelin qendror, unë jam e zgjedhur në nivel lokal dhe foli për këtu, se llogari nga unë kërkojnë qytetarët e këtij vendi për ku jam zgjedhur. Duhet me qenë transparent, kërkesat me i trajtuar me rënd, e jo një kërkesë me pritur 2-3 vjet, se paku nëse nuk mundet me iu miratuar, me ia kthyer një përgjigje palës, se për shkak të PZHK apo arsye tjera nuk mundet me u miratuar, se pritja është e neveritshme për qytetarin.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesën për shpallje me interes publik të një prone, e bënë komuna, se për ndryshe qytetarët mund të bëjnë kërkesa në vazhdimësi, por çështja është: A ka interes komuna për atë pronë me shpallë interes publik. Kur e ka bërë pala atë kërkesë, komuna nuk ka pasur interes, tani ka interes publik dhe e aktivizon atë kërkesë?

z. Agim Mani: Kërkesat duhet me i trajtuar në formë të drejtë. znj. Kadrije e potencoj një kërkesë të komunitetit para 3-4 muajve për një rrugë, komisioni ende nuk ka dalë në vendngjarje. Një kërkesë ka qenë për rrugë edhe në lagjen Hysa me hapur një rrugë, ndërkaq ju nuk keni formuar as komision me dalë në vendngjarje. Duhet me i trajtuar kërkesat, se a është interes publik i komunës apo i qytetarit. Fillimisht komuna duhet me pasur buxhetin e ndarë për atë pronë, pastaj me shpallë interes publik pronën.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse komuna ka interes publik për një pronë, e shpallë me interes publik edhe pa kërkesë, ta paguan pronën dhe e merr.

Kryetari i Komunës: Kur shtëpitë kanë dalë në pronë publike, ka qenë interes i qytetarit për me këmbyer pronën. Kërkesa për me hapur një rrugë është diçka tjetër, ndërkaq renditja e kërkesave për shpallje me interes publik shkon sipas nevojave të komunës, si çështja e pronave për autostradë.

z. Agim Mani: Nëse është urgjente kërkesa, cili është projekti dhe a i keni ndarë mjetet. Kjo kërkesë nuk është urgjente dhe nuk keni buxhet për këtë kërkesë.

Kryetari i Komunës: Interesi është se pala donë me rregulluar çështjen e parcelave të shtëpia e tij. Shtëpia është e ndërtuar para 30 viteve. Ka shumë ndërtime pa leje, janë 8 mijë ndërtime pa leje, ato kanë me u legalizuar ndonjë ditë, jo krejt përmjetherë, por me pjesë, ose kanë me u legalizuar ose prishur.

z. Agim Mani: Interesi në këtë rast është i palës, jo i komunës. Ne duhet kuptuar qartë se këtu interesi është individual.

z. Qamil Stagova: Pse nuk shkoni me u interesuar pse Jeton Raka e shtynë PSV, që me vazhduar me PZHK.

Kryetari i Komunës: Ka shumë kërkesa që janë adresuar nga komunitetet për me lëshuar për rrugë, janë nja 100 kërkesa, por nuk jemi duke pasur mundësi me i kryer krejt përnjëherë. Ende kemi çështjet të shpronësimit për autostradën.

znj. Kadrije Lika-Troni: Uroj krejt kërkesat, me u shqyrtuar si kjo që është bërë në këtë muaj, por çështja është të shikohen kërkesat sipas radhës.

Kryetari i Komunës: Pajtohem me juve në këtë drejtim.

Kryesuesi i Kuvendit: Në momentin kur ekzistuar me mundësia me u bërë zgjedhje për një pronë, që ka qenë interes publik i komunës për një shesh apo diçka tjetër, ju kemi bërë zgjidhje, por kjo nuk shkon sipas renditjes, por sipas interesit publik. Ligji për procedurë administrative e rregullon qartë afatin e shqyrtimit të kërkesave, afati është 30 ditë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kërkesat që adresohen, secila me ditur kur e ka radhën, me qenë transparente kërkesat.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa kërkesat adresohen këtu të palëve, nuk e di a është në rregull me u bërë publike. Sipas LPA, kërkohet qasje në një kërkesë.

znj. Ardita Rrahmani: Jam kundër asaj që kërkesat me u bërë publike, se kërkesat dhe nevojat e individëve janë nga me të ndryshme. Po e adresoj një çështje për vendimet që janë marrë në lidhje me marrëveshjet mes komunave dhe qeverive, janë diku 49 vendime që i kanë lidhë komunat me ministrinë e infrastrukturës për rrugë. Nuk e pash që komuna e Kaçanikut figuron me ndonjë rrugë aty. Me intereson me ditur, a keni bërë kërkesë specifike, nëse po, atëherë a kemi mundësi në KK me pa kërkesën, për arsye se edhe ne kemi shumë të drejtë, pavarësisht nga jemi, interesi i qytetarëve për ne është primar. A mundemi me i pasur ne KK kërkesat të cilat janë adresuar ministrisë për rrugët konkrete specifike, për fat të mirë e kemi një zëvendësministër nga komuna jonë në qeveri dhe një deputet në Kuvendin e Kosovës, me çka mundemi me kërkuar llogari, përse komuna e jonë nuk është përfshirë në asnjë projekt. Unë nuk e pash për vendimet që janë marrë në atë mbledhje, ndërsa ndoshta mundet me ndodhur me ndonjë vendim tjetër të qeverisë, por po foli për vendimet të cilat i pash se nuk është përfshirë komuna e Kaçanikut.

Kryetari i Komunës: Mundem me ua dërguar me kërkesa me projekt detal me arsyetim, se nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Janë duke përfunduar mandati dhe përpos 60 mijë euro që janë investuar në Kaçanik, ndonjë investim tjetër nuk ka pasur. Kërkesat iu kanë adresuar ministrisë së financave, komisionit për politikë dhe financa dhe deputetit nga komuna jonë. Janë të dhëna zyrtare, iu kemi dërguar edhe dy deputetëve, Ilmiut dhe Rashitit, deri tani përgjigje nuk kemi.

znj. Ardita Rrahmani: Thirrja e ministrisë ka qenë publike, nëse nuk gaboj në muajin prill. A mundemi si anëtarë të KK me i pasur këto informata.

Kryetari i Komunës: Po mundeni me i pasur.

Kryesuesi i Kuvendit: A po e kërkoni si informatë për KK apo si pikë.

znj. Ardita Rrahmani: Unë po diskutoj sot, mbledhja e qeverisë është para 3-4 ditëve, nëse realizohet diçka në rregull, nëse jo, unë e paraqes edhe zyrtarisht në mbledhje të KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF

Aprovoj

Propozim Vendimin për shpallje në interes publik të parcelave kadastrale në Zona kadastrale Kaçanik dhe Kovaçec. Ky propozim vendim i Rekomandohet

Kryesuesi i Kuvendit: Në mbledhjen e KK është kërkuar të diskutohet çështja e ujit në komunën e Kaçanikut. Me u thirr me raportuar dhe përfaqësuesi i Bifurkacionit Ferizaj dhe drejtori i DSHPE.

z. Agim Mani: Ka njohuri të mjaftueshme drejtori i DSHPE.

Kryesuesi i Kuvendit: Jo drejtori i DSHPE, por përfaqësuesi i KRU "Bifurkacionit" Ferizaj, do të na njoftoj për menaxhimin e ujit të pijes.

Kryetari i Komunës: Çështja e ujit ka kaluar në nivel qendror që 3 vite, nuk kemi kurrfarë njohurish kush lajmërohet apo shkarkohet, nuk e dimë as kush është anëtar i bordit në nivel qendror. Mirë është me ftuar në KK me na sqaruar dhe me ditur KK çfarë kompetencash kemi ne si komunë dhe keni me u bindur se nuk kemi kompetencash. Ne mundem me bërë një shkresë zyrtare , është bërë shkresa zyrtare në javën e kaluar, por më tepër nuk mundemi me bërë dhe nuk mundemi me detyruar me ardhur këtu. Neve nuk na pyet askush.

Kryesuesi i Kuvendit: A pajtoheni me ftuar në interpelancë drejtorin ekzekutiv të "Bifurkacionit" Ferizaj.

znj. Ardita Rrahmani: Në KK është kërkuar me u debatuar çështja e ujës-jellësit, ndërkaq nga administrata duhet me kërkuar se a është ftuar drejtori ekzekutiv i "Bifurkacionit".

z. Agim Mani: A mundemi me lënë në një mbledhje tjetër, çështjen e interpelancës?

Kryesuesi i Kuvendit: Në muajin gusht nuk kemi mbledhje të KK.

Kryetari i Komunës: Me "Pastërtinë" nuk kemi pasur vërejtje, ndërkaq për çështjen e ujit ka ankesa nga qytetarët e komunës. Për 3 vjet janë investuar gati 600 mijë euro, por menaxhimin nuk e kemi.

znj. Ardita Rrahmani: Puna e ujit, nuk pret, jemi në sezon të verës dhe duhet me bërë zgjidhje.

z. Agim Mani: Ministria i ka investuar mbi 1 milion euro në çështjen e ujit të pijes, drejtori i DSHPE duhet me reaguar nëse nuk ka menaxhim të mirë.

Kryetari i Komunës: Çështjen e menaxhimit nuk e kemi ne, janë edhe Hidromorava, Hidrodriini, krejt këto kompani kanë kaluar në nivel qendror.

Kryesuesi i Kuvendit: Kryeshefi Ekzekutiv dhe Drejtori kanë kompetenca, ky që është emëruar tani, nuk ka ende.

znj. Kadrije Lika –Troni: Gjendja e ujit është e rënë në kohën që jemi, ndërkaq ju nuk po e dini se a është ftuar kryeshefi i KRU "Bifurkacioni" apo jo.

Kryetari i Komunës: Kërkesa është për KK, jo për këtu.

Kryesuesi i Kuvendit: Si konkludim i këtij diskutimi, mbetet që përmes zyrtarëve të Ekzekutivit-DSHPE, t'i dërgohet Ftesa Kryeshefit të KRU "Bifurkacioni" në Ferizaj për me na

informua në mbledhjen e 7 të rregullt të KK të datës 31.07.2024, për çështjen e ujësjellësit në komunën e Kaçanikut, e cila do të jetë pikë e rendit të ditës në mbledhjen.

Kryetari i Komunës: Çështja është ngritur në KK dhe kjo është punë e KK me ftuar, por po e marrë unë për sipër me ftuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Vija për shkresa shkon prej ekzekutivit, është DSHPE. Në mbledhje të ftohet Kryeshefi Ekzekutiv dhe drejtori i DSHPE, për me na informua për çështjen e menaxhimit të ujit në komunën tonë.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:03. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët sa ishin prezentë - 06.

Vazhdimi i mbledhjes së 6 të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 28.06.2024, do të mbahet me 31.07.2024, në ora 10:00, me pikët e mbetura 13-15.

Ndërsa, Mbledhja e 7 e Rregullt e Kuvendit të Komunës do të mbahet me 31.07.2024, në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu
M Malsiu

